

**VENDIM**  
**Nr.1026, datë 9.7.2008**

**PËR CAKTIMIN E DIETËS DITORE TË USHTARAKËVE SHQIPTARË, TË  
DËRGUAR NË REPUBLIKËN E ÇADIT DHE NË REPUBLIKËN E AFRIKËS  
QENDRORE, NË KUADËR TË OPERACIONIT USHTARAK “EUFOR TCHAD/RCA”,  
TË BASHKIMIT EUROPIAN**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 3, të aktit normativ nr.3, datë 28.5.2008 të Këshillit të Ministrave “Për dërgimin në Republikën e Çadit dhe Republikën e Afrikës Qendrore, si kontribut i Republikës së Shqipërisë, të një kompanie të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, për të marrë pjesë në operacionin “EUFOR Tchad/RCA”, të Bashkimit European”, dhe të nenit 8 të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2008”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Dieta ditore e ushtarakëve shqiptarë, të dërguar në Republikën e Çadit dhe në Republikën e Afrikës Qendrore, në operacionin “EUFOR Tchad/RCA”, të Bashkimit European, të jetë 60 (gjashtëdhjetë) euro/ditë qëndrimi në mision. Trajtimi financiar të fillojë nga data e dërgimit me mision.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, në masën 90 675 000 (nëntëdhjetë milionë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë) lekë, të përballohen nga buxheti i vitit 2008, miratuar për Ministrinë e Mbrojtjes.

3. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**